



## KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 31 janar 2011, në mbledhjen e IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr.31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama, ndërkaq mungoi z. Radisav Peroviq.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Habil Sylejmani Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra rajonale në Prishtinë-Ekipi për komunitete, z. Suzana Kourilova, LMT – KFOR dhe z. Muhamed Lushaku, KAAD.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### 2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 dhjetor 2010

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### 3. Propozimi i Raportit të punës për vitin 2010

**z. Burhan Blakçori**, nënvizoi, në këtë Raport është pasqyruar puna mjaftë e madhe që është bërë në vitin 2010, për çka kemi pasur fjalë miradije nga OSBE se në kuadër të rajonit të Prishtinës jemi Komitet që është angazhuar dhe ka punuar në nivelin e duhur.

Përndryshe, kemi qenë unik dhe kemi dhënë kontributin tonë në çështjet të cilat janë shqyrtuar gjatë vitit për të cilin po raportohet, mirëpo konsideroj se ndoshta nuk jemi angazhuar sa duhet në aspektin e ofrimit të ndihmave financiare për disa raste sociale meqë ne jemi bazuar vetëm në rekomandimet që ua kemi dërguar Drejtorive përkatëse të Administratës.

Jam i mendimit se me një qasje dhe angazhim më të madh do të realizohen objektivat dhe synimet e parapara për vitin 2011.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, u pajtua me parafolësin dhe shtoi, për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk i kemi realizuar vizitat që kanë qenë të planifikuara për vitin 2010.

**z. Fadil Babatinca**, theksoi, të gjitha çështjet duhet të planifikohen me kohë ashtu siç është dashtë të planifikohen edhe mjetet përkatëse financiare për vizitat që i ceku parafolësi.

Pas votimit u konstatua se Raporti i punës për vitin 2010 u miratua njëzëri.

#### **4. Propozimi i Planit të punës për vitin 2011**

**z. Burhan Blakçori**, theksoi, në këtë propozim të Planit të punës janë shkoqitur në detaje të gjitha çështjet me rëndësi në përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive të këtij Komiteti ku përveç tjerash janë paraparë vizita në lokalitetet ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë, vizita në shkolla në funksion të përcjelljes së gjendjes dhe identifikimit të brengave dhe problemeve eventuale të nxënësve të komuniteteve pakicë. Gjithashtu është paraparë edhe bashkëpunimi me Komitetet për Komunitete të komunave tjera të Republikës së Kosovës si dhe itinerari për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të këtij Komiteti.

**z. Nebih Behluli**, theksoi, me hartimin e këtij materiali është bërë punë e mirë e mbi të gjitha për faktin se qysh në fillim të vitit është përgatitur Plani i punës, plan i cili është mjaftë ambicioz dhe përmban kaptinat e domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të këtij Komiteti. Po ashtu prek fushat e nevojshme siç janë avancimi i marrëdhënieve ndëretnike, vizitat në lokalitete ku jetojnë komunitetet pakicë, vizitat në shkolla si dhe kujdesi për gjendjen sociale të komuniteteve pakicë.

Pra jam i mendimit se janë përfshirë të gjitha aspektet e nevojshme që duhet t'i ketë një Plan i punës dhe si i tillë i plotëson kushtet për miratim.

**Arbresha Hetemaj**, nënvizoi, synimet dhe objektivat e parapara në Planin e punës për vitin 2011 duhet të merren më seriozisht në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të mos ndodh sikur vitin e kaluar që të mos realizohen vizitat e parapara në disa komuna të Republikës së Kosovës, pra është i nevojshëm një angazhim i përbashkët më i madh për realizimin e plotë të këtij plani.

**Jahë Lahu**, shprehu mendimin se Plani i punës për vitin 2011 është më i avancuar se Plani i punës për vitin 2010 ngase në vitin 2011, përveç tjerash, parashihen edhe vizita në shkolla për të përcjellë vijueshmërinë në mësimet të nxënësve pjesëtarë të komuniteteve pakicë. Sa i përket vijueshmërisë në mësimet të këtyre nxënësve jam në dijeni se ka braktisje të shkollimit, por jo në masën për të cilën mendohet, mirëpo kjo do të vërtetohet gjatë vizitave të cekura.

Pajisjen me libra për nxënës të shkollave fillore e bënë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërkaq mbi bazën e angazhimit të Komitetit për Komunitete, për nxënësit e shkollave të mesme pajisjen me libra e ka bërë Komuna e Podujevës.

**z. Mefail Mustafa**, shprehu mendimin se me këtë Plan të punës në mënyrë detaje janë paraparë punët, angazhimet dhe objektivat për vitin 2011 dhe shtoi, konsideroj se duhet paraparë edhe çështja e Zyrës komunale për komunitete dhe kthim e cila i raporton Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Drejtorisë së Administratës por njëkohësisht është e obliguar të bashkërendoj të gjitha aktivitetet me institucionet komunale dhe më gjerë, andaj mbi këtë bazë propozoj që në këtë plan të përfshihet edhe:

- Shqyrtimi i raportit të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, çdo tre muaj.

Gjithashtu vitin e kaluar janë shqyrtuar disa kërkesa për ofrimin e ndihmave momentale financiare për të cilat ky Komitet i ka bërë rekomandimet përkatëse Drejtorive kompetente, andaj në këtë kontekst do duhej të përfshihet :

- Shqyrtimi i realizimit të rekomandimeve të këtij Komitete, çdo tre muaj.

**z. Nebih Behluli**, u pajtua me propozimet e parafolësit.

Pas votimit u konstatua se kjo pikë e rendit të ditës u miratua njëzëri me plotësimet e paraqitura nga z. Mefail Mustafa.

## **5. Të ndryshme**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, shtroi çështjen e shqyrtimit të mundësive për ngritjen e shumës së mëditjes për anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pas dialogut të bërë, njëzëri u vendos që kjo çështje të shtrohet në ndonjë takim me kryetarët e Komiteteve për Komunitetet të komunave tjera, apo së paku me kryetarët e Komiteteve për Komunitetet të rajonit të Prishtinës, në mënyrë që të merret qëndrim i përbashkët për propozimin e ngritjes së mëditjeve.

**Mbledhja përfundoi në orën 12,55 .**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01/10-06  
Podujevë,  
31 janar 2011**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**